

DEKRET
Nr.5393, datë 22.3.1976

**MBI DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVE TOKËSORE TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 7 të ligjt nr.4352 datë 23.12.1967 “Mbi këshillat popullore”,

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në rrethin e Lushnjës

1. Fshati Çerragë dhe Kosovë e madhe, shkëputen nga fshati i bashkuar Jeta e re e rrethit të Lushnjës dhe lidhen me fshatin e bashkuar NB-Belsh të rrethit të Elbasanit.

II. Në rrethin e Kukësit

1. Fshati i bashkuar i Domgjoni dhe Fshatrat e tij Domgjoni dhe Heba, shkëputen nga rrethi i Kukësit dhe lidhen me rrethin e Mirditës.

2. Fshati i Bashkuar Klos dhe fshatrat e tij Bisaka, Klosi, Xhuxha, Zall-Xhuxha, Thirra, Konaj dhe Shëngjini, shkëputen nga rrethi i Kukësit dhe lidhen me rrethin e Mirditës.

3. Fshati i bashkuar Srriqe dhe fshatrat e tij Moll-Kuqja dhe Srriqja, shkëputen nga rrethi i Kukësit dhe lidhen me rrethin e Pukës.

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

Sekretari
Telo Mezini

Kryetari
Haxhi Lleshi